



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 61 Prot

Tiranë, më 29.04, 2013


VENDIM Nr. 257, dt. 29.04.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.04.2013, mbasi shqyrtoi Projektin: "Lezhë - Varreza dhe Kalaja", Bashkëdrejtues Dr. Elvana Metalla (Instituti i Arkeologjisë, Qendra e Studimeve Albanologjike) dhe Dr. Etleva Nallbani (Shkolla Franceze e Romës), pjesë e paketës së projekteve, miratuar nga Këshilli Shkencor i IA (QSA),

VENDOSI:

- I. Të dorëzohet një kopje e marrëveshjes dypalëshe midis Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike) dhe Shkollës Franceze të Romës, pranë Sekretarisë Teknike të KKA.

- II. Të paraqitet relacioni i plotë i projektit ku të përcaktohen objektivat kryesore në lidhje me kërkimet arkeologjike të planifikuara në territorin brenda Kalasë Mesjetare të Lezhës për të evituar mbivendosjet me **Vendimin Nr. 243, datë 08.02.2013.**
Nëpërmjet vendimit të mësipërm, KKA ka miratuar raportin përfundimtar të sondazheve arkeologjike në kuadër të Projektit: "Rijetëzimi i Kalasë Mesjetare të Lezhës", të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik me konsulencë shkencore të Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike).
Në bazë të rezultateve të sondazheve arkeologjike, përpara çdo ndërhyrje me karakter restaurimi, konservimi apo rijetëzimi, duhet të realizohet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

gërmim arkeologjik shpëtimi.

- III. Vazhdimi i projektit arkeologjik lejohet pas plotësimit të kushteve të mësipërme.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

VISAR ZHITI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
www.asha.gov.al